



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
VLORE

NR. 383 i Rregjistrimit
DT.02.09.2014 i Rregjistrimit

Nr. 274/60-2014-2778 i vendimit
Dt. 09.12.2014 e Vendimit

V E N D I M
“Në emër të Republikës”

Gjykata e Apelit Vlore, e përbërë nga gjyqtarët:

Margarita Buhali - Kryesuese
Andi Civici - Anëtar
Hysen Saliko- Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore [REDACTED], më datat 11.11.2014, 03.12.2014, 09.12.2014 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile me nr.383 rregjistri, me datë rregjistrimi 02.09.2014, që i përket:

KËRKUES; Drejtoria Rajonale e Shëndetsisë Fier- përfaqësuar nga znj. [REDACTED]

Persona të tretë: 1- [REDACTED] banuese në lagjen [REDACTED], përfaqësuar nga avokate [REDACTED]

2- [REDACTED] banuese në lagjen [REDACTED] përfaqësuar nga avokate [REDACTED]



3- [REDACTED] banues në lagjen [REDACTED] rruga [REDACTED] në mungesë.

4- [REDACTED] banues në lagjen [REDACTED] rruga [REDACTED] - në mungesë.

5-Komisioni për mbrojtjen nga diskriminimi – në mungesë.

Objekti: Rivendosjen në afat të rekursit ndaj vendimit nr.280 dt. 20.02.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë i cili ka lënë në fuqi vendimin nr. 1017 dt.04.06.2013 i Gjykatës së rrethit gjyqsor Fier.

BAZA LIGJORE : Nenet 151-152 te K. Pr.Civile.



Në përfundim të gjykimit;

Kërkuesi nëpërmjet përfaqësueses kërkoi; Pranimin e kërkesës.

Personat e tretë nëpërmjet përfaqësueses kërkuan: Rrëzimin e kërkesës.

GJYKATA E APELIT VLORE

Pasi degjoi relatimin e gjyqtares Margarita Buhali; degjoi përfaqësuesin e kërkueses që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesen e personave të tretë që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe shqyrtoi ceshtjen ne teresi,

V Ë R E N

Cështja është paraqitur për gjykim në gjykatën e Apelit Vlorë mbi bazën e vendimit nr. 62-2014-2675 /572 dt.15.07.2014 të Gjykatës së Rrethit gjyqsor Fier e cila ka konstatuar moskompetencën lëndore për shqyrtimin e cështjes pasi sipas nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile Gjykata e Apelit Vlorë është gjykata që ka dhënë vendimin për të cilin kërkohet rivendosja në afat e rekursit.

Kerkuesi Drejtoria rajonale e shëndetsisë Fier ka kërkuar rivendosjen në afat të rekursit kundër vendimit nr. 280 dt. 20.02.2014 të gjykatës së Apelit Vlorë me pretendimin se ka humbur afatin e rekursit për shkak të pasqyrimit gabim në këtë vendim se ka qënë e përfaqësuar ndërkohë kur nuk ka pasur përfaqësues në gjykimin në apel. Për këtë ajo paraqiti në gjykim vendimin nr.280 dt. 20.02.2014 të gjykatës së Apelit Vlorë dhe dëftesën e kominikimit të vendimit.

Personat e tretë kundërshtuan pretendimet e ngritura nga kërkuesi me arsyetimin se vendimi i gjykatës së Apelit i ishte komunikuar kërkuesit me dëftesë komunikimi dhe ajo nuk kishte bërë rekurs kundër vendimit. Nga Ministri i Shëndetsisë i është kërkuar drejtorisë rajonale Fier, që kjo e fundit të bëjë ekzekutimin e vendimit, por ajo po përpiket të krijojë cdo lloj mundësie për të mos vazhduar ekzekutimin. Për sa mësipër personat e tretë kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe pagimin e shpenzimeve gjyqsore.

Nga gjykimi i cështjes rezultojnë faktet e mëposhtme: Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr.280 dt. 20.02.2014 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1017 dt. 04.06.2013 të Gjykatës së Rrethit gjyqsor Fier. Në këtë vendim gjykata e rrethit gjyqsor Fier ka vendosur të konstatojë faktin e diskriminimit dhe të viktimizimit të paditëses nga i padituri Drejtoria Rajonale e shëndetsisë Fier, ndreqjen e kësaj situatë duke u rikthyer paditësja në vendin e mëparëshëm të punës ose në një pozicion të barasvlefshëm, detyrimin e të paditurit ta dëmshpërblejë atë dhe

ndërhyrësit kryesor me dëmin jopasuror në shumën 4 507 868 lekë. Vendimi nr.280 dt.20.02.2014 i Gjykatës së Apelit Vlorë është dhënë në mungesë të palës së paditur Drejtoria Rajonale e shëndetsisë Fier, fakt që është pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit. Në këtë vendim për palën e paditur gabimisht është shënuar përfaqësuar me autorizimin nr.66/2 prot dt. 15.02.2013, por në krah të këtij shënimi nuk ka asnjë emër personi përfaqësues, por është shënuar menjëherë pas datës “në mungesë”. Vendimi i gjykatës së Apelit Vlorë i është njoftuar rregullisht palës së paditur në datën 31.03.2014 nëpërmjet dëftesës së komunikimit të datës 27.03.2014. Në datën 15.05.2014 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të rekursit duke pretenduar si shkak gabimin në autorizim të vendosur në vendimin e apelit i cili e ka konfunduar atë duke menduar se ankimi do të bëhej nga përfaqësuesja e personit të tretë të pasqyruar si përfaqësuese edhe e të paditurit në gjykimin në shkallë të parë. Personi i tretë [REDAKTUAR] e kundërshton këtë kërkim me pretendimin se njoftimi i vendimit të apelit i është bërë rregullisht kërkuesit. Gjykata e shkallës së parë ka korrigjuar pasqyrimin e gabuar në vendim se i padituri ishte përfaqësuar nga z. [REDAKTUAR] e cila ka qënë në fakt përfaqësuesja e personit të tretë Komisioni për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gjykata e Apelit Vlorë pasi shqyrtoi pretendimet e të dyja palëve dhe provat e paraqitura, cmon se kërkesa për rivendosjen në afat të rekursit është e pabazuar në ligj. Sipas nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se; *kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme mund të paraqesin kërkesë për rivendosjen në afat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin.* Në rastin konkret kërkuesi nuk provoi në gjykim se ka humbur afatin ligjor të rekursit për shkaqe të arsyeshme pasi;

1-Në vendimin nr.280 dt.20.02.2014 të gjykatës së Apelit Vlorë është pasqyruar rregullisht se pala e paditur Drejtoria rajonale e shëndetsisë Fier ka qënë në mungesë në zhvillimin e gjykimit dhe në shpalljen e vendimit. Mbi këtë bazë i padituri është njoftuar rregullisht për këtë vendim me dëftesë komunikimi dt 27.03.2014. Pikërisht me njoftimin e vendimin në datën 31.03.2014 , ka filluar të ecë afati i rekursit për Drejtorinë Rajonale së Shëndetsisë Fier, afat i cili ka përfunduar pa u ushtruar e drejta e rekursit.

2-Fakti se në vendimin e gjykatës së Apelit gabimisht është shkruar një numër protokolli dhe datë autorizimi nuk sjell asnjë efekt në humbjen e afatit të rekursit. Në pasqyrimin e këtij fakti mungon emrin i personit të autorizuar për përfaqsim, gjë që e bën të qartë se ky shënim në vendim është një gabim material. Për me tepër ,në kushtet kur në vendim është pasqyruar se i padituri ka qënë në mungesë, ky fakt rrëzon të gjithë konfundimin që mund të krijohet nga shënimi i autorizimit me numer e datë protokolli.

3-Kërkuesi nuk mund të justifikojë mosparaqitjen e rekursit në afat me arsyetimin se ka menduar se ankimi do të bëhej nga personi që i ishte dhënë autorizimi. Ky pretendim është i pabazuar, pasi në rradhë të parë në vendimin e apelit nuk dihej se cili ishte personi i autorizuar. E drejta e rekursit është një e drejtë ekskluzive që i përket mbajtësit të saj, që në rastin konkret është Drejtoria Rajonale e Shëndetsisë Fier dhe jo përfaqsuari. Ky i fundit mund të ushtrojë një të drejtë të tillë vetëm kur i është dhënë shprehimisht nga i përfaqsuari. Në kushtet kur në vendimin e gjykatës së apelit nuk citohet një person përfaqsuar i të paditurit, ky i fundit nuk mund të justifikojë se e drejta e rekursit do të ushtrohej nga një person tjetër i cili nuk dihet se kush ishte.

4-Qëndrimi i mbajtur nga kërkuesi në kërkesë del haptazi i pabazuar edhe nga krahasimi me qëndrimin e mbajtur po prej tij në rastin e ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Edhe pse në vendimin e gjykatës së shkallës së parë është shënuar gabimisht se i padituri është përfaqsuar nga znj. [REDAKTUAR] që në realitet ishte përfaqsuara e personit të tretë, ky fakt nuk e ka penguar të paditurit të paraqes ankim kundër vendimit. Cështja është bërë objekt shqyrtimi në gjykatën e Apelit vetëm mbi ankimin e të paditurit Drejtoria Rajonale e Shëndetsisë Fier ndërsa personi i tretë Komisioni i mbrojtës kundër diskriminimit nuk ka bërë ankim kundër këtij vendimi. Në këto kushte nuk ekzistonte asnjë rrethanë, e cila do të konfondonte të paditurit Drejtoria Rajonale e shëndetsisë se rekusi do të paraqitej nga përfaqsuari i personit të tretë që mund të ishte njëkohësisht dhe përfaqsuari i tyre.

Nga sa mësipër rezulton se kërkuesi Drejtoria Rajonale e Shëndetsisë Fier si institucion shtetëror është njoftuar rregullisht për vendimin e gjykatës së Apelit nr.280 dt.20.02.2014 dhe nuk ka paraqitur rekurs ndaj tij, megjithëse i ka pasur të gjitha mundësitë të realizonte një të drejtë të tillë. Gjykata e Apelit cmon se kërkesa e kërkuesit për rivendosjen në afat të rekursit është e pabazuar në ligj dhe në prova e si e tillë duhet të rrëzohet.

Personi I tretë kërkoi ngarkimin e palës kërkuese me shpenzimet gjyqsore të kryera për përfaqsimin me avokat duke depozituar në gjykatë faturën tatimore të dates 09.12.2014 sipas të cilës marrëveshja e palëve për shpenzimet avokatore për këtë gjykim është në masën 50 000 lekë. Sipas nenit 106 të K.Pr.Civile I padituri ka të drejtë të kërkojë shpenzimet gjyqsore në rast të rrëzimit të kërkesëpadisë. Po në bazë të nenit 195 të K.Pr.Civile personi I tretë pjesëmarrës në gjykim ka të gjitha të drejtat që I njihen edhe palëve me përjashtim të atyre që sjellin disponim të të drejtës.

Pavarësisht nga mënyra e ndërtimit të ndërgjyqësisë në cështjen me objekt rivendosje në afat të rekursit, pozicioni I kërkuesit dhe I personit të tretë [REDAKTUAR] është kontradiktor, I ngjashëm më pozicionin e paditësit dhe të paditurit.

Këtë qëndrim ata e kanë reflektuar edhe gjatë gjykimit, pasi interesi I kërkuarit është të rivendoset e drejta e rekursit në afat si një mundësi për atakimin e ndryshimin e vendimit , ndërsa personi I tretë kundërshton këtë kërkim me qëllim që çështja e tij të konsiderohet e zgjidhur përfundimisht me vendim të pacënueshëm. Nën interpretimin e nenit 106 të Kodit të Procedurës Civile, personi I tretë [REDAKTUAR] si pala që çënohet nga kërkimet e kërkuarit dhe që nuk I ka dhënë shkak kërtimeve të tij, legjitimohet të kërkojë pagimin e shpenzimeve gjyqsore të kryera për llogarit të mbrojtjes së të drejtave të tij në gjykim, ku përfshihen ato avokatore. Nëpërmjet faturës tatimore vërtetohet se këto shpenzime janë në masën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë . Fatura përbën njëkohësisht dhe marrëveshje të personit të tretë [REDAKTUAR] me përfaqësues pasi është e nënshkruar prej të dy këtyre subjekteve rregullisht. Për sa mësipër kërkuari ngarkohet me pagimin e shpenzimeve gjyqsore të kryera nga [REDAKTUAR] në masën 50 000 lekë.

PER KETO ARSYE

Gjykata e Apelit Vlore, bazuar ne nenin 306 e vijues,
te Kodit te Procedures Civile,

VENDOSI

- Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova.
- Shpenzimet gjyqsore në masën 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë të parapaguara nga [REDAKTUAR] i ngarkohen kërkuarit.

U shpall në Vlorë më 09.12.2014

ANETAR
Hysen Saliko
d.v.

ANETAR
Andi Civici
d.v.

KRYESUESE
Margarita BUHALI
d.v.

